FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.78 29 qershor 2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.27, datë 20.6.2007	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë……..	2331
Vendim i GJK nr.28, datë 20.6.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.854, datë 9.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.282, datë 21.4.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.339, datë 18.5.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën…..	2333
Vendim i GJK nr.29, datë 22.6.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.175/1, datë 28.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën	2335
Vendim i GJK nr.30, datë 25.6.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.3624, datë 17.11.2000 dhe nr.894, datë 14.3.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1131, datë 4.11.2003 dhe nr.982, datë 23.9.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe nr.1524, datë 26.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën……	2337

VENDIM
Nr.27, datë 20.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i	“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i	“ “
Kujtim Puto	Anëtar i	“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i	“ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 4.4.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30 Akti, që i përket:

KËRKUES: KUJTIM NELI, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. MINISTRIA E FINANCAVE, në mungesë.
2. KËSHILLI I QARKUT DIBËR, në mungesë.
3. ZYRA E PËRMBARIMIT DIBËR, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Kërkuesi, duke iu referuar nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka parashtruar pretendimet e tij në këto drejtime kryesore:

- Organet shtetërore nuk kanë respektuar detyrimin e parashikuar në nenin 142 të Kushtetutës, sipas të cilit organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore.
- Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor për një periudhë prej 10 vjetësh është në kundërshtim me konceptin kushtetues të zgjidhjes së çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Komisioni i Kthimit të Pronave Dibër, me vendimin nr.51, datë 24.8.1996, i ka njohur nënës së kërkuesit pronësinë mbi një shtëpi banimi (që sot nuk ekziston) dhe mbi këtë bazë e ka kompensuar me vlerën 1.113.867 lekë.

Meqenëse ky vendim nuk është ekzekutuar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila me vendimin nr.18, datë 20.1.2003 ka vendosur detyrimin e Këshillit të Qarkut Dibër ta kompensojë atë në shumën e mësipërme, duke vendosur gjithashtu që kjo shumë të llogaritet në bazë të koefiçentit të rivlerësimit për zbatim në ditën e ekzekutimit të vendimit. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimet nr.622, datë 15.5.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1450, datë 15.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, në zbatim të vendimit gjyqësor, ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr.107, datë 15.10.2003. Zyra e Përmbarimit Dibër e ka vënë çështjen në lëvizje nëpërmjet lajmërimeve për ekzekutim vullnetar drejtuar Këshillit të Qarkut Dibër, i cili nga ana e tij është përgjigjur me shkresë, se ka qenë në pamundësi financiare për ekzekutimin e shumës së

mësipërme për mungesë të mjeteve monetare. Mbi këtë bazë, Zyra e Përmbarimit Dibër i është drejtuar Ministrisë së Financave për çeljen e fondit përkatës. Ministria e Financave nëpërmjet korrespondencës zyrtare ka vënë në dijeni Zyrën e Përmbarimit Dibër se vendimet gjyqësore që lidhen me detyrime financiare likuidohen nga fondet e miratuara nga institucioni përkatës, pasi më parë të analizohen faktet dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.

Përmbaruesi gjyqësor, me vendimin nr.292, datë 30.12.2005, ka pushuar ekzekutimin e Urdhrit Ekzekutiv nr.107, datë 15.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me arsyetimin se Këshilli i Qarkut Dibër nuk disponon fondin e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Ndaj këtij vendimi të përmbaruesit gjyqësor, kërkuesi nuk ka paraqitur ankim. Ndodhur në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe kërkon prej saj konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Gjykata Kushtetuese çmon se në kuptim të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, individi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete.

Gjykata Kushtetuese konstaton se për rastin në shqyrtim, kërkuesi megjithëse i ka pasur në dispozicion, nuk ka shterur mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore. Sipas nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile, kundër vendimit të pushimit të përmbaruesit gjyqësor mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë. Në këto kushte, përderisa nuk është shfrytëzuar ky instrument juridik që ligji i ka lënë në dispozicion kërkuesit për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese e ligjore, çështja nuk mund të përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "f" dhe 134, pika 1 shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.28, datë 20.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar	i "	"
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"
Vjollca Meçaj	Anëtare	e "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Kristofor Peçi	Anëtar	i "	"

me sekretare Brunilda Bara, në datë 11.4.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.33 Akti, që i përket:

KËRKUES: GANI SHEHU, në mungesë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.854, datë 9.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.282, datë 21.4.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.339, datë 18.5.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 34, 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi pretendon se vendimet e mësipërme janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor për këto shkaqe:

- Procedimi penal nuk duhej të fillonte ose duhej të ishte pushuar sipas kërkesave të neneve 327/1, shkronja "d", dhe 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, në bazë të nenit 66/1 shkronja "c" të Kodit Penal;

- Vepra e kualifikuar si vjedhje me anë të mashtrimit ka përfunduar në datën 16.1.1997 dhe deri ditën e marrjes si i pandehur në datë 5.7.2002, kanë kaluar 5 vjet e 6 muaj, kur afati ligjor i parashkrimit ka qenë 5 vjet.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi, nëpërmjet avokatit të tij, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese shfuqizimin e vendimeve të gjykatave sipas objektit të kërkesës. Në seancën e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, avokati i kërkuesit nuk u paraqit, megjithëse kishte dijeni siç del nga komenti i tij me shkrim paraqitur në këtë Gjykatë, se është njoftuar që gjykimi i çështjes do të bëhej në datën 11.4.2007, në ora 10.^{00}. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese zhvilloi seancën në mungesë të kërkuesit dhe avokatit të tij duke u bazuar në nenin 38/6 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", sipas të cilit: "Kur kërkuesi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre, megjithëse janë njoftuar, nuk paraqiten në seancë plenare dhe për këtë nuk kanë paraqitur shkaqe të përligjura, seanca plenare zhvillohet në mungesë".

Nga aktet rezulton se me vendimin nr.854, datë 9.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuesi është deklaruar fajtor për veprën penale të vjedhjes së pasurisë me anë të mashtrimit në vlerën 115.000.000 lekë në dëm të 1430 personave dhe në bazë të nenit 143 të Kodit Penal është dënuar me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, gjykata ka pezulluar ekzekutimin e vendimit për një periudhë prove prej 5 vjetësh.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.182, datë 21.4.2004, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor përsa i përket kualifikimit ligjor, deklarimit fajtor dhe masës së dënimit dhe e ka ndryshuar atë duke revokuar pezullimin e ekzekutimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.339, datë 4.5.2005, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Pretendimi i kërkuesit për zhvillim të një procesi të parregullt ligjor për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, hyn në rrethin e çështjeve që i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Është e natyrshme se zhvillimi i ndjekjes penale në një kohë kur ajo është shuar për shkak të parashkrimit e bën procesin të parregullt.

Por, megjithëse në parim çështje të tilla duhet të jenë objekt shqyrtimi kushtetues, për rastin konkret Gjykata Kushtetuese është e mendimit se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk ka bazë dhe duhet të rrëzohet.

Sipas pretendimeve të kërkuesit, nga momenti i përfundimit të veprës penale deri në marrjen e tij si të pandehur, kanë kaluar më tepër se 5 vjet, prandaj ndjekja penale nuk duhej të fillonte ose duhej të pushonte. Ky pretendim i tij është ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë dhe Kolegji Penal që ka shqyrtuar çështjen e ka konsideruar të pabazuar, sepse vepra penale e kryer nga kërkuesi përbën një vepër latente (krim vazhdues), për faktin se nuk ka shlyer 1430 debitorë në shumën prej 115.000.000 lekë.

Në rrethanat që paraqitet çështja, pretendimi i ngritur nga kërkuesi se është dënuar për një vepër të parashkruar, nuk provohet.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa duhet të rrëzohet sepse nuk rezulton që gjykatat e sistemit gjyqësor të kenë zhvilluar proces gjyqësor të parregullt.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.29, datë 22.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i " "
Fehmi Abdiu	Anëtar i " "
Kristofor Peçi	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "
Vjollca Meçaj	Anëtare e " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "

me sekretare Brunilda Bara, në datë 2.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.35/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: AGRON PAPAJANI

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga inspektorët Izet Sala, Mine Progonati, me autorizim

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.175/1, datë 28.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kërkuesi ka pretenduar papajtueshmërinë e vendimit të mësipërm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me Kushtetutën, sepse marrja e masës disiplinore të transferimit, është bërë në shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, për shkaqet si vijon:

- Gjatë kohës që Këshilli i Lartë i Drejtësisë ishte tërhequr për vendim, në sallë ndodheshin edhe persona të palegjitimuar.
- Vendimi i transferimit është bazuar në nenin 11/3 të Rregullores së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dispozitë kjo që tejkalon përmbajtjen e ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë". Ajo që parashikon neni 11/3 i Rregullores është një procedurë e re, të cilën ligji i mësipërm nuk e parashikon.
- Nëpërmjet zbatimit të procedurës së paligjshme që parashikon neni 11/3 i Rregullores, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shkelur të drejtën e njoftimit, të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe të drejtën për t'u mbrojtur në një proces disiplinor.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, është shprehur se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, duke parashtruar:

- Gjyqtarit Agron Papajani në asnjë etapë të procedimit disiplinor nuk i është cenuar e drejta e informimit, e drejta për t'u dëgjuar, si dhe e drejta për t'u mbrojtur.

- Nuk është i bazuar pretendimi për paligjshmërinë e nenit 11 të Rregullores së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

- Kërkesa për rregullimin e pasojave të ardhura nga vendimi i kundërligjshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk përbën objekt të shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkuesin, përfaqësuesit e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen,

VËREN:

Me vendimin nr.175/1, datë 28.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndaj kërkuesit është marrë masa disiplinore e "transferimit në një gjykatë tjetër, të një niveli më të ulët", duke u caktuar nga gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh.

Kundër vendimit të mësipërm, kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.11, datë 8.3.2006, kanë vendosur – pushimin e gjykimit të çështjes së ngritur nga gjyqtari Agron Papajani, për mungesë juridiksioni.

Pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shpalljen e vendimit të mësipërm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe rregullimin e pasojave të ardhura nga ky vendim, duke pretenduar se është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës. Sipas kërkuesit, procesi i parregullt konsiston në atë, se në sallën e mbledhjes së Këshillit kanë qenë të pranishëm edhe persona të palegjitimuar për të marrë pjesë. Përveç kësaj, vendimi për transferimin e tij është bazuar në nenin 11/3 të Rregullores së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dispozitë kjo që tejkalon përmbajtjen e ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë". Nëpërmjet kësaj procedure të Rregullores, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shkelur të drejtën e njoftimit, të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe të drejtën për t'u mbrojtur në një proces disiplinor.

Gjykata Kushtetuese verifikoi nëse kjo Gjykatë ka juridiksion për shqyrtimin e kërkesës së mësipërme.

Në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkuesi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, sepse ai nuk u është drejtuar fillimisht gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Sipas ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", neni 34/1, gjyqtarit i ishte njohur e drejta të ankohej në Gjykatën e Lartë për masa disiplinore më të lehta se ajo e shkarkimit. Por, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.29, datë 9.11.2005, shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën atë pjesë të dispozitës që lejonte ankimin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë për këto lloj masash disiplinore.

Neni 147 i Kushtetutës ka parashikuar kompetencën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të ndërhyjë e të marrë masa për disiplinimin e gjyqtarëve në ato aspekte që lidhen me ushtrimin e funksioneve e ruajtjen e figurës së gjyqtarit. Por, ndërsa për shkarkimin nga detyra Kushtetuta u ka dhënë të drejtë gjyqtarëve të ankohen në Gjykatën e Lartë, për masat e tjera disiplinore nuk përcakton organin ku ata mund të ankohen dhe as mënyrën e shqyrtimit të këtyre ankesave. Llojin dhe natyrën e masave disiplinore, si dhe procedurën e marrjes së tyre, Kushtetuta e ka lënë në vlerësimin e ligjvënësit.

Gjykata Kushtetuese duke pranuar se "Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënësit, që në kuptim të standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve, të përfshijë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë shqyrtimin e ankimit ndaj masave të tjera disiplinore", nuk ka konsideruar si të papajtueshëm me Kushtetutën shqyrtimin e ankesave të gjyqtarëve kundër masave disiplinore të dhënë ndaj tyre nga gjykatat e zakonshme.

E drejta e çdo individi për t'iu drejtuar gjykatës buron nga neni 42 i Kushtetutës. Kushtetuta i ka deleguar ligjvënësit kompetencën, që nëpërmjet ligjit, të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që lidhen me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, por pa u shprehur për të drejtën e ankimit të tyre dhe për organin që do t'i shqyrtojë këto ankime.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut përcakton të drejtat themelore të njeriut, por ajo nuk ndalon që shtetet palë të parashikojnë më shumë të drejta e liri për individët, ndërsa Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 17 të saj e ka pranuar përmbajtjen e Konventës Europiane si minimumin e standardit, pa penguar që legjislacioni ynë t'i japë më shumë të drejta e liri si dhe një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit.

Legjislacioni ynë nuk ka parashikuar ndonjë kufizim për të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatave të zakonshme. Përkundrazi, ai kishte pranuar të drejtën e ankimit të tyre në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë edhe në rastet e masave disiplinore të dhëna nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Nëse Gjykata e Lartë ka ndalim kushtetues pasi një juridiksion i tillë fillestar nuk i është dhënë shprehimisht nga Kushtetuta. Një ndalim të tillë nuk e kanë gjykatat e tjera të zakonshme, të cilat kanë një juridiksion fillestar të përgjithshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.30, datë 25.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i " "
Fehmi Abdiu	Anëtar i " "
Kristofor Peçi	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Vjollca Meçaj	Anëtare e " "

me sekretare Brunilda Bara, në datat 1.12.2006 dhe 1.2.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.44/14 Akti, që i përket:

KËRKUES: STEFAN PRIFTI, përfaqësuar nga avokat Abaz Brati, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: ENVER RUKA, trashëgimtar ligjor i Hasan Rukës, përfaqësuar nga avokat Gjet Kola, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.3624, datë 17.11.2000 dhe nr.894, datë 14.3.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1131, datë 4.11.2003 dhe nr.982, datë 23.9.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe nr.1524, datë 26.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 6 e 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe kryesore:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka zhvilluar gjykimin e çështjes në mungesë të tij, në kushtet kur nuk kishte dijeni për datën e gjykimit dhe kërkesëpadinë e ngritur kundër tij, për arsye se njoftimet e gjykatës nuk janë bërë sipas rregullave dhe formës të parashikuar në ligj.

- Është shkelur barazia e palëve, sepse gjykimi është zhvilluar në një seancë, në të cilën është dëgjuar vetëm paditësi dhe nuk është bërë një hetim i plotë rreth çështjes.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur parimin e kompetencës, sepse ka gjykuar padinë me një vlerë 6 milionë lekë me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, ndërkohë që sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, çështja duhej gjykuar nga 3 gjyqtarë;

- Gjykimi i kërkesëpadisë tjetër, e ngritur nga kërkuesi, me objekt detyrimin e palës së interesuar (Hasan Ruka) të zbatojë kontratën e premtim shitjes së truallit, është zhvilluar gjithashtu vetëm në një seancë dhe vendimi është dhënë pa shqyrtuar provat e paraqitura prej tij, gjë që e bën gjykimin të njëanshëm.

Subjekti i interesuar ka parashtruar:

- I ndjeri Hasan Ruka, 83 vjeç, vuante nga skleroza dhe veprimet me pasuritë e tij të paluajtshme janë kryer vetëm nën kujdesin e djalit të tij, me përjashtim të kontratës objekt shqyrtimi. Kërkuesi ka dashur të abuzojë, duke përfituar nga gjendja shëndetësore e të ndjerit.

- Kontratës objekt shqyrtimi i mungojnë elementet e domosdoshme të kërkuara nga ligji për transaksionet me pasuri të paluajtshme, siç janë vlera e pasurisë në kontraktim, garancitë për premtimin e shitjes, kopja origjinale e vërtetimit të pronësisë në momentin që premtohej të shitej etj., prandaj me të drejtë ajo është deklaruar e pavlefshme nga gjykatat.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesin e kërkuesit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.3624, datë 17.11.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë dhe deklarimin e pavlefshmërisë të kontratës nr.428 Rep., dhe nr.72 Kol., datë 2.3.2000, me objekt premtim shitje toke, lidhur midis paditësit Hasan Ruka e të padituri Stefan Prifti. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1131, datë 4.11.2003, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1524, datë 26.7.2004, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i padituri.

Përafërsisht në të njëjtën kohë, në 16.11.2000, edhe kërkuesi Stefan Prifti i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt detyrimin e të padituri Enver Ruka të zbatojë kontratën premtim shitje toke, të cituar më sipër, të lidhur midis tyre në 2.3.2000. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.894, datë 14.3.2000, ka vendosur rrëzimin e kësaj padie, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.982, datë 23.9.2004, e ka lënë atë në fuqi. Kundër këtij vendimi nuk është parashtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Cenimin e së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor kërkuesi e pretendon, për shkak se, sipas tij, gjatë gjykimit të konfliktit civil ku ai ishte thirrur si i paditur, gjykatat kanë shkelur të drejtën e tij për mbrojtje, kanë shkelur parimin e barazisë së palëve, parimin e kompetencës gjyqësore, si dhe kanë zhvilluar gjykime të njëanshme.

Ndryshe nga sa pretendohet, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në dijeni kërkuesin lidhur me kërkesëpadinë e ngritur ndaj tij, për datën e zhvillimit të veprimeve paraprake si dhe datën e gjykimit, duke dërguar për këtë qëllim njoftimet përkatëse në adresën e saktë të kërkuesit. Në kushtet kur njoftimet janë kthyer të pakomunikuara, pasi pala e paditur ndodhej jashtë shtetit, ajo i ka shpallur ato sipas ligjit, duke i vendosur si pranë gjykatës që do të shqyrtonte çështjen, ashtu dhe në vendbanimin e kërkuesit. Më pas kërkuesi erdhi në dijeni të vendimit gjyqësor të dhënë për çështjen e shqyrtuar pa praninë e tij dhe për ta kundërshtuar atë kërkoi rivendosjen në afat, kërkesë të cilën gjykata ia pranoi.

Mbi këtë bazë kërkuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit, por nuk është treguar i interesuar të marrë pjesë në shqyrtimin e tij nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkuesi ka ushtruar, gjithashtu, të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese çmon se nga sa më sipër rezulton se kërkuesit nuk i është mohuar e drejta e mbrojtjes, apo e barazisë së armëve. Ai ka pasur të gjitha mundësitë të parashtrojë nëpërmjet ankimit me shkrim, por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në shqyrtimin e tij në gjykim nëse do të kishte dëshiruar, të gjitha pretendimet dhe prapësimet lidhur me padinë e ngritur ndaj tij. Gjykata e Apelit Tiranë, si gjykatë fakti, ka shqyrtuar në seancë gjyqësore gjithçka që kërkuesi ka parashtruar në ankimin e tij, edhe pse ankimuesi nuk ishte i pranishëm. Ndonëse gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar vetëm me një palë, kjo nuk rezulton të ketë ndodhur për faj të gjykatës.

Lidhur me pretendimin për shkelje të parimit të gjykatës kompetente, Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu se nuk qëndron. Kontratës objekt gjykimi vetë palët nuk rezulton t'i kenë përcaktuar vlerë. Nga vendimet gjyqësore dhe nga materialet e dosjes rezultoi se asaj kontrate i mungojnë, veç vlerës së përgjithshme, edhe çmimi për metër katror i truallit, gjendja juridike e pronës që premtohej të shitej, e të tjerë elemente të domosdoshme, mungesa e të cilave ka bindur gjykatat për pavlefshmërinë e aktit noterial. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim përpara gjykatës së apelit.

Gjykata Kushtetuese nuk merr në shqyrtim pretendimet lidhur me vendimin nr.894, datë 14.3.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr.982, datë 23.9.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për arsye se kërkuesi nuk ka shterur të gjitha mjetet juridike pranë sistemit të zakonshëm gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të tij, siç kërkohet nga neni 131/f i Kushtetutës. Ai nuk ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj këtyre vendimeve gjyqësore.

Në kushtet sa më sipër, Gjykata Kushtetuese përfundimisht i gjen të pabazuara pretendimet e kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1300**
4.	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…….….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…….….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR……**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET…….....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)……**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE…….....**	**500**

Hyri në shtyp më 27.6.2007
Doli nga shtypi më 29.6.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë